**REPUBLIKA E SHQIPËRISE**
**KËSHILLI I BASHKISË**
**KORÇË**

**VENDIM**
**Nr** 127 **Datë** 27.11.08

**PER**
**Miratim fondi për Qendrën Rezidenciale të Zhvillimit**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Finances « Miratim fondi për Qendrën Rezidenciale të Zhvillimit » bazuar në ligjin nr. Mbi 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32 pika dh, ligjin nr.9836 dt. 26.11.2007 « Per buxhetin e Shtetit te vitit 2008 », Udhezimin nr.4 dt.17.01.08 i M.F « Per zbatimine buxhetit te shtetit per vitin 2008 ».Udhezimin nr 258 dt. 15.02.2008 i Ministrise se Brendshme « Per zbatimin e buxhetit te qeverisjes vendore per vitin 2008 », V.K.B nr. 12 dt. 18.03.2008 « miratimin e buxhetit te Bashkise dhe institucioneve te vartesise per vitin 2008 », Ligji nr. 9936 date 26.06.2008 « Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise » mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

**VENDOSI**

**1.**Të miratoje kontributin financiar të Bashkisë me vlerën prej 200,000 lekësh.

**2.** Ky fond do të përballohet nga fondi rezervë i të ardhurave të Bashkisë, nga e cila 100,000 lekë do të përdoren për organizimin e koktejit dhe blerje dhuratash për klientët e qendrës dhe 100,000 lekë do të përdoren për plotësimin e nevojave të këtij institucioni në zërin shpenzime operative. me kete strukture buxhetore :

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Pakësohet | 00 | 04980 | 05 | Art | 6090000 | - 200 000 |
| Shtohet | 25 | 10430 | 06 | Art | 6020000 | + 200 000 |

**3.**Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Qendra Rezidenciale e Zhvillimit.

**4.**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

***Kryetari***
Raimonda Nase
**Raimonda Nase**

Dixhitalizuar nga Qendra ÇIP
www.infocip.org